

VENDIM
Nr. 611, datë 23.10.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE TË UDHËTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 4, pika 6, 5, pika 13, 9, pika 3, 10, pika 4, 15, pika 6, 16, pika 4, 17, pika 3, 18, pikat 3 e 4, 19, pika 3, 20, pika 5, dhe 21, pika 3, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përpunimin e të dhënave të udhëtimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 954, datë 2.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për përpunimin e të dhënave të pasagjerit”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Byroja Kombëtare e Hetimit, Shërbimi Informativ i Shtetit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe Policia Ushtarake për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLORE
“PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE TË UDHËTIMIT”

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë, për grumbullimin, përpunimin, shpërndarjen apo shkëmbimin e të dhënave, sipas parashikimeve në nenin 8, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave, që kanë të bëjnë me:

1. Organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Inteligjencës së Udhëtimit (SIU);

2. Transmetimin dhe mbrojtjen e të dhënave të udhëtimit;
3. Përdorimin dhe kontrollin e aksesit në bazat e të dhënave;
4. Përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave;
5. Shenjëstrimin;
6. Shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit të udhëtimit;
7. Përcaktimin e rregullave për funksionimin dhe bashkëpunimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale me autoritetin kombëtar mbikëqyrës;
8. Përcaktimin e rregullave për procedurat e autorizimit të transmetimit të informacionit të udhëtimit.

Neni 3 **Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Certifikata e sigurisë së personelit (CSP)”** dhe **“Nevojë për njohje”**, i njëjti kuptim siç përcaktohet në nenin 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”;
2. **“Kanale të sigurta të komunikimit”**, mjete fizike ose elektronike, të cilat sigurojnë transmetimin e informacionit të klasifikuar pa rrezik komprometimi;
3. **“Personeli SIU”**, punonjësit nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe punonjësit e autoriteteve operative, të emëruar apo të caktuar në detyrë pranë SIU-t dhe që ushtrojnë detyrat funksionale sipas ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, dhe kësaj rregulloreje.

KREU II SEKTORI I INTELIGJENCËS SË UDHËTIMIT

Neni 4 **Ngritja dhe funksionimi i SIU-t**

1. Sektori i Inteligjencës së Udhëtimit (SIU) është një strukturë ndërinstitutionale, që ngrihet dhe funksionon në Departamentin për Policinë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. SIU përbëhet nga punonjës të Policisë së Shtetit dhe të autoriteteve operative të përcaktuara në ligjin nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.
3. SIU operon 24 orë, pa ndërprerje, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit.
4. E drejta e aksesit e punonjësve të SIU-t në bazat e të dhënave të autoriteteve operative përkatëse jepet me urdhër të titullarëve të tyre, bazuar në parimin “nevojë për njohje”.

Neni 5 **Statusi i SIU-t**

1. Personeli i SIU-t, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, ka detyrime e të drejta të barabarta dhe kalon në varësi lëndore të SIU-t për periudhën e qëndrimit në këtë strukturë.

2. Të gjithë punonjësit, për njohje me informacionin e klasifikuar, pajisen me certifikatë sigurie të personelit me nivelin “Tepër sekret”.
3. Personeli i SIU-t raporton te shefi i sektorit të SIU-t për detyrat funksionale në këtë strukturë.

Neni 6

Trajtimi financiar i punonjësve të SIU-t

Të gjithë punonjësit e SIU-t, përfshirë përfaqësuesit e autoriteteve operative, trajtohen me pagë bazë sipas nivelit dhe funksionit në strukturat e autoriteteve operative përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Kriteret e emërimit e të kualifikimit për punonjësit e SIU-t

1. Të gjithë punonjësit e SIU-t, përfshirë përfaqësuesit e autoriteteve operative, duhet të plotësojnë këto kriteret minimale:
 - a) të jenë punonjës me përvojë mbi 5 (pesë) vjet në institucionet përkatëse;
 - b) të kenë njohuri të gjuhës angleze;
 - c) të zotërojnë certifikatë sigurie të personelit (CSP) të vlefshme, në nivelin “Tepër sekret”;
 - ç) të kenë njohuri të avancuara për sistemet kompjuterike dhe analizën e të dhënave.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për emërimin në SIU, përzgjedh punonjës me përvojë në fushat e kufirit e të migracionit, të hetimit të krimit, të terrorizmit, të analizës së informacionit, si dhe punonjës përgjegjës për teknologjinë dhe informacionin.

Neni 8

Pikat e kontaktit të autoriteteve kompetente

1. Autoritetet kompetente caktojnë pika kontakti për bashkëpunimin me SIU-n me një kohëzgjatje njëvjeçare.
2. Në rastet e ndryshimit të pikës së kontaktit, autoritetet kompetente vënë menjëherë në dijeni SIU-n.
3. Pikat e kontaktit duhet të jenë punonjës me përvojë mbi 5 vjet, mundësisht në fushën e analizës së informacionit dhe të pajisur me certifikatë sigurie të vlefshme të nivelit “Tepër sekret”.
4. Pikat e kontaktit të autoriteteve kompetente janë dhe anëtarë të njësisë së emergjencave të SIU-t, e cila mbledhet në rastet e emergjencave kombëtare dhe drejtohet nga drejtuesi i SIU-t.

Neni 9

Përfaqësuesit e autoriteteve operative pranë SIU-t

1. Çdo autoritet operativ cakton deri në 5 specialistë pranë SIU-t, të cilët veprojnë brenda mjediseve të tij dhe në përputhje me protokollet e sigurisë.
2. Përfaqësuesit e caktuar janë specialistë të SIU-t për kohën e qëndrimit në këtë strukturë.
3. Autoritetet operative ruajnë të drejtën për të mos caktuar përfaqësues fizikisht pranë SIU-t, por bashkëpunojnë sipas procedurave standarde të punës të miratuara nga titullarët e autoriteteve operative.

4. Në rastet e parashikuara nga pika 3 e këtij neni, autoritetet operative komunikojnë nëpërmjet kanaleve të sigurta të komunikimit, të postës elektronike ose sipas rregullave të parashikuara për informacionin e klasifikuar.

Neni 10

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Bashkëpunojnë me SIU-n për përmbushjen e detyrimeve të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, të gjitha autoritetet kompetente dhe operative, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Punëve të Brendshme:

i. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me të gjitha strukturat e saj;

b) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

c) Ministria e Financave:

i. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

ii. Agjencia e Inteligjencës Financiare;

ç) Ministria e Mbrojtjes:

i. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

ii. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

iii. Policia Ushtarake;

d) Shërbimi Informativ i Shtetit;

dh) Byroja Kombëtare e Hetimit;

e) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Mospërmbushja e detyrimeve nga institucionet e varësisë raportohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në autoritetet kompetente.

KREU III

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE TË UDHËTIMIT

Neni 11

Llojet e informacionit të udhëtimit

1. Të gjithë transportuesit në kuptimin e nenit 5, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, transmetojnë të dhënat e udhëtimit pranë SIU-t, si më poshtë vijon:

a) të dhënat paraprake të informacionit të pasagjerit (të gjitha llojet e dhënave API);

b) të dhënat e regjistrimit të emrit të pasagjerit (të dhënat PNR);

c) të dhënat e ngarkesave (kargo të manifestit të udhëtimit për mallrat).

2. Të dhënat e udhëtimit, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, transmetohen për të gjitha udhëtimet e planifikuara me mjete ujore, ajrore dhe tokësore, përfshirë rastet e transportit ujor dhe ajror të përgjithshëm apo udhëtimet me charter, për qëllime joushtarake, që:

a) nisen nga Republika e Shqipërisë me destinacion vende të tjera;

b) nisen nga vende të tjera me destinacion Republikën e Shqipërisë ose transit në të gjithë hapësirën (ajrore, ujore dhe tokësore) nëpërmjet Republikës së Shqipërisë.

3. Kur transporti kryhet me kod të përbashkët, ndërmjet një ose më shumë transportuesve, transportuesi që kryen udhëtimin është i detyruar të transmetojë pranë SIU-t të dhënat, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, për të gjithë pasagjerët.

4. Kur transportuesi nuk mbledh të dhënat API dhe PNR, por i disponon këto të dhëna në format tjetër, atëherë ai do të dërgojë të dhënat e udhëtimit, sipas formatit të përcaktuar nga SIU, brenda një muaji nga momenti i informimit nga ana e SIU-t. Transportuesi duhet të përputhë sistemet me ato të standardeve ndërkombëtare për një periudhë kohore të përcaktuar nga SIU.

5. Të dhënat e ngarkesave në të gjitha rastet e transporteve përfshijnë të gjitha elementet e dokumentacionit detyrues për udhëtim, ku janë të përcaktuara të paktën:

a) të dhënat e manifestit të përgjithshëm:

- i. numri i manifestit;
- ii. data e dorëzimit të manifestit;
- iii. lloji i transportit (ajror, detar, tokësor);
- iv. emri i mjetit të transportit;
- v. flamuri ose vendi i regjistrimit të mjetit të transportit;
- vi. porti/terminali i nisjes;
- vii. porti/terminali i destinacionit;
- viii. emri i operatorit ose i kompanisë transportuese;

b) të dhënat për çdo njësi mallrash/ngarkese:

- i. numri i ngarkesës (*shipping bill/waybill*/B/L);
- ii. emri dhe adresa e eksportuesit (dërguesit);
- iii. emri dhe adresa e importuesit (marrësit);
- iv. emri i agjentit përfaqësues në port/doganë (nëse ka);
- v. përshkrimi i mallrave;
- vi. kodi HS (tarifor doganor);
- vii. pesha bruto dhe neto e ngarkesës;
- viii. vëllimi (në m³);
- ix. numri i paketave dhe lloji i paketimit;
- x. marka dhe numri i kontejnerëve (nëse përdoren);
- xi. statusi i ngarkesës (import, transit, eksport);
- xii. vendi i origjinës së mallrave;
- xiii. vendi i destinacionit final;
- xiv. të dhëna të tjera ndihmëse (nëse kërkohet nga SIU);
- xv. deklarata për mallra të rrezikshme (nëse ka);
- xvi. vlera e deklaruar për doganë;
- xvii. numri i konosamentit (*Bill of Lading*) ose *Air Waybill*;
- xviii. informacione për pagesën e transportit (*freight prepaid/collect*);
- xix. referenca të veçanta ose komente të tjera;
- xx. nënshkrimi i kapitenit, i agjentit apo i përfaqësuesit të transportuesit;
- xxi. vula e kompanisë ose e operatorit të transportit;
- xxii. pika e kalimit kufitar të hyrjes/daljes.

6. Transmetimi i të dhënave të udhëtimit kryhet te SIU në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një operatori ekonomik për të mundësuar leximin e formateve/protokolleve të të dhënave të udhëtimit, si dhe për t'i transmetuar në sistemet e përpunimit të të dhënave të SIU-t.

7. Transportuesit nuk duhet të mbledhin, të përpunojnë dhe të transmetojnë të dhëna sensitive, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast se transportuesit transmetojnë të

dhëna të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, SIU kryen menjëherë fshirjen e tyre në mënyrë të pakthyeshme.

8. Transmetimi i të dhënave nga transportuesit bëhet elektronikisht në mënyrë të sigurt ("*push*"), sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

9. Të dhënat e transmetuara përtej përcaktimeve në këtë rregullore apo që nuk i shërbejnë qëllimit të ligjit nr. 38/2025, "Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë", fshihen në mënyrë manuale nga punonjësi i caktuar nga drejtuesi i SIU-t.

Neni 12

Baza e të dhënave të udhëtimit

1. Baza e të dhënave të udhëtimit përmban të gjitha informacionet e udhëtimit të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Punonjësit e SIU-t kanë akses në bazën e të dhënave të udhëtimit, sipas parimit "nevojë për njohje", për informacionin e klasifikuar dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Administrimi dhe përpunimi i të dhënave të informacionit të udhëtimit bëhet vetëm me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të parashikuara në pikën 1, të neni 8, i ligjit nr. 38/2025, "Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë".

4. Zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit e të mbrojtjes së të dhënave personale gjatë veprimtarisë së përpunimit të të dhënave të udhëtimit mbikëqyret dhe monitorohet nga nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave, si dhe nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 13

Transmetimi dhe grumbullimi i të dhënave të udhëtimit

1. Transportuesit transmetojnë informacionin e udhëtimit në të gjitha formatet dhe protokollet, që ato kanë dhe në përputhje me ato të përcaktuara në këtë rregullore, të harmonizuara me formularët tip për transmetimin e informacionit të udhëtimit të miratuar nga Bashkimi Evropian.

2. Transportuesit transmetojnë të dhënat paraprake të pasagjerit (të dhënat API) deri në fund të *check-in*-it për të paktën tre shtytje (*push*), sipas përcaktimeve në shkronjën "e", të pikës 6, të këtij neni dhe përcaktimeve në manualin e udhëzimeve të SIU-t.

3. Transportuesit transmetojnë të dhënat e udhëtimit, sipas kohës dhe afateve të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 38/2025, "Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë".

4. Në raste të veçanta, kur vlerësohet se rreziku për kryerjen e veprave penale apo kur personi paraqet rrezik për sigurinë publike dhe atë kombëtare, dhe ky rrezik është real e i çastit, me kërkesën e SIU-t, të dhënat PNR transmetohen menjëherë.

5. Në rastet e vërtetuara dhe pas përpunimit të të dhënave, që lidhen me rrezikun kombëtar apo rrezikun publik, SIU njofton menjëherë autoritetet kompetente, të cilat vendosin menjëherë bllokimin për imbarkim të pasagjerit apo të mallit kargo.

6. SIU grumbullon të dhënat e udhëtimit, që transmetohen nga transportuesit, si më poshtë vijon:

a) kodin e konfirmimit të rezervimit të pasagjerit;

b) datën e rezervimit e të lëshimit të biletës;

c) emrin/emrat dhe mbiemrin e pasagjerit;

ë) adresën dhe të dhënat e kontaktit, përfshirë numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike;

d) informacionin për biletën, përfshirë numrin, datën e lëshimit, biletat në një drejtim, kuotat e automatizuara të tarifave të biletës, mënyrën e pagesës, adresën IP, si dhe adresën e përdorur për faturimin e saj;

dh) të gjithë informacionin në lidhje me bagazhin;

e) informacionin paraprak të pasagjerit (API) të mbledhur, përfshirë llojin, numrin, vendin e lëshimit dhe datën e skadimit të çdo dokumenti udhëtimi, shtetësinë, emrin dhe mbiemrin, emrin/emrat e tjerë, gjininë, datën e lindjes, linjën ajrore, numrin e fluturimit, datën e nisjes, datën e mbërritjes, aeroportin e nisjes, aeroportin e mbërritjes, kohën e nisjes dhe kohën e mbërritjes, si dhe numrin në total të pasagjerëve, që transportohen;

ë) itinerarin e plotë të udhëtimit;

f) informacion për pasagjerë të shpeshtë;

g) agjencinë dhe agjentin e udhëtimit;

gj) statusin e udhëtimit të pasagjerit, përfshirë konfirmimin, statusin e *check-in-it*, mosparaqitjen për *check-in*, biletën pa rezervim;

h) informacionin mbi kode të ndryshme apo të veçuara të konfirmimit të rezervimit;

i) informacionet për të mitur të pashoqëruar nën 18 vjeç, si: emri dhe gjinia e të miturit, mosha, gjuha/gjuhët që flet, emri dhe detajet e kontaktit të kujdestarit në nisje dhe lidhja/marrëdhënia e tij me të miturin, emrin dhe detajet e kontaktit të kujdestarit në mbërritje dhe lidhja/marrëdhënia e tij me të miturin;

j) numrin e ndenjësës dhe informacione të tjera të lidhura me ndenjësën;

k) informacion për kodin e përbashkët të fluturimit;

l) numrin total të pasagjerëve, si dhe të dhënat identifikuese të udhëtarëve të tjerë, që rezultojnë në regjistrin e rezervimit të pasagjerit;

ll) të gjitha ndryshimet historike në të dhënat e pasagjerëve të listuara nga shkronja “a” deri në shkronjën “ll”, të kësaj pike.

7. SIU grumbullon të dhënat e përcaktuara në këtë nen, që do të transmetohen për të gjitha udhëtimet e planifikuara, përveç transportit me qëllime ushtarake, të cilat:

a) nisen nga Republika e Shqipërisë me destinacion vende të tjera;

b) nisen nga vende të tjera me destinacion Republikën e Shqipërisë ose transit në të gjithë hapësirën (ajrore, ujore, tokësore) nëpërmjet Republikës së Shqipërisë.

8. Ndalohet përpunimi i të dhënave të udhëtimit, që zbulojnë karakteristikat e personit, të cilat përbëjnë shkak diskriminimi, sipas legjislacionit të posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rast se të dhënat e udhëtimit zbulojnë një informacion të tillë, ato fshihen menjëherë nga SIU.

9. Ndalohet përpunimi i të dhënave sensitive, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 14

Përpunimi i të dhënave të udhëtimit

1. SIU përpunon të dhënat e udhëtimit vetëm me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të parashikuara në nenin 8, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

2. SIU përpunon të dhënat e udhëtimit, me qëllim identifikimin e personave, për të cilët ka arsye të besohet se kanë kryer ose dyshohet se do të kryejnë një veprë penale të përcaktuar në pikën 1, të nenit 8, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

3. Për qëllimet e parashikuara nga pikat 1 dhe 2, të këtij neni, SIU autorizohet të kryejë veprimet, si më poshtë vijon:

a) të kryejë kërkime automatike kundrejt bazave të të dhënave në përdorim nga autoritetet operative;

b) të kryejë kërkime automatike kundrejt bazave të të dhënave të agjencive ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, lidhur me personat apo sendet në kërkim, ku Republika e Shqipërisë është anëtare apo i ka njohur ato;

c) të vendosë, në bashkëpunimin me autoritetet operative, kritere apo rregulla të reja për vlerësimin e riskut të pasagjerëve dhe të mallrave;

ç) të bëjë vlerësimin e të dhënave të udhëtimit përpara mbërritjes ose nisjes së tyre të planifikuar në ose nga Republikën/a e Shqipërisë, me qëllim identifikimin e personave, për të cilët kërkohet ekzaminim i mëtejshëm nga autoritetet operative, kur persona të tillë dyshohen se mund të përfshihen në vepra terroriste ose krime të rënda;

d) të bashkëpunojë me autoritetet kompetente dhe operative, që të hartojnë profilet e riskut, në funksion të zbatimit të përcaktimeve të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 38/2025, të cilat përmbajnë kritere të sakta. Këto kritere duhet të kenë objektiv të qartë, të jenë proporcionale dhe specifike. Kriteret nuk duhet të bazohen, në asnjë rrethanë apo rast konkret, në të dhënat e origjinës racore apo etnike, mendimet politike, besimin fetar ose filozofik, anëtarësinë në sindikata, problemet shëndetësore, jetën seksuale ose orientimin seksual. Në rast se të dhënat e përpunuara zbulojnë një informacion të tillë, ato fshihen menjëherë nga SIU;

dh) të analizojë të dhënat e udhëtimit, me qëllim rishikimin, të paktën çdo gjashtë muaj, dhe/ose vendosjen e kritereve të reja, që do të përdoren në vlerësimet që kryhen, me qëllim identifikimin e personave, që mund të jenë të përfshirë në akte terroriste ose të krimit të organizuar dhe krimet e rënda. Rishikimi i kritereve bëhet në bashkëpunim me autoritetet operative dhe nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave dhe, për çdo ndryshim apo vendosje të kritereve të reja, njoftohet me shkrim Departamenti i Policisë Kriminale.

4. Kriteret e reja dhe ndryshimi i tyre i mundshëm miratohen nga drejtori i Departamentit të Policisë Kriminale, me propozim të SIU-t, pas konsultimit e dakordësimit me autoritetet operative.

5. Çdo vlerësim i pasagjerit apo i transportuesve, që bëhet bazuar në kriteret e vendosura në zbatim të kësaj rregulloreje, para mbërritjes ose nisjes së tyre të planifikuar, duhet të bëhet në respektim të të drejtave themelore të njeriut.

6. Autoritetet operative nuk marrin asnjë vendim që sjell një efekt të pafavorshëm juridik ndaj një udhëtarit apo transportuesit vetëm për shkak të përpunimit automatik të të dhënave. Vendime të tilla nuk do të merren në bazë të racës ose të origjinës etnike të një personi, mendimeve politike, fesë ose bindjeve filozofike, anëtarësimit në sindikata, shëndetit, jetës seksuale ose orientimit seksual.

7. Në çdo rast të rezultateve pozitive nga kërkimet automatike të bazës së të dhënave të udhëtimit, me qëllim vlerësimin e nevojës për marrjen e masave ligjore të mëtejshme nga autoritetet operative, SIU do të bëjë analizimin e mëtejshëm të të dhënave, në mënyrë joautomatike.

8. SIU transferon për ekzaminim të mëtejshëm tek autoritetet operative të dhënat e udhëtimit të personave të identifikuar, në përputhje me pikën 2 të këtij neni ose rezultatin e përpunimit të këtyre të dhënave. Transferimi, në të tilla raste, do të bëhet vetëm rast pas rasti dhe në rast të përpunimit të automatizuar të të dhënave, pas analizimit individual në mënyrë joautomatike.

9. Rezultatet e vlerësimeve të të dhënave të udhëtimit të kryera në zbatim të pikës 2 të këtij neni, në asnjë rast nuk rrezikojnë të drejtën e hyrjes në Republikën e Shqipërisë të shtetasve të huaj, të parashikuar në legjislacionin kombëtar dhe në marrëveshjet dypalëshe.

10. Autoritetet operative, pasi kanë analizuar informacionin e dërguar nga SIU për verifikime të mëtejshme, sipas pikës 7 të këtij neni, janë të detyruar t'i kthejnë përgjigje të menjëhershme SIU-t për pasurimin e informacionit.

11. Procedurat për përpunimin dhe shkëmbimin e të dhënave të udhëtimit, sipas këtij neni, do të parashikohen në procedura standarde të punës, që miratohen me urdhër të përbashkët të titullarëve të autoriteteve operative.

Neni 15

Shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit

1. Shkëmbimi ndërkombëtar i të dhënave bëhet me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, me Interpolin dhe Europolin, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit operacional dhe me vendet joanëtare të Bashkimit Evropian, në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe dhe të nivelit të sigurisë së të dhënave personale, në rastet kur:

a) nga kontrolli i bërë apo nga përpunimi i informacionit të udhëtimit rezulton se ato janë të nevojshme për autoritetet ligjzbatuese të vendeve dhe agjencive ndërkombëtare, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për parandalimin, zbulimin, hetimin apo ndjekjen penale të veprave, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 8, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

b) autoritetet ligjzbatuese të vendeve dhe agjencive ndërkombëtare, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kanë paraqitur një kërkesë të arsyetuar, që provon se shkëmbimi/marrja i/e të dhënave të regjistrimit të rezervimit të pasagjerit është i nevojshëm për të parandaluar kryerjen e veprave penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 8, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në rastet e identifikimit të personave sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, SIU dërgon ose shkëmben informacionin e nevojshëm të udhëtimit ose rezultatet e përpunimit të të dhënave pranë strukturave homologe të përpunimit të informacionit të udhëtimit ose sipas kërkesës së agjencisë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje bashkëpunimi.

3. Për çdo rast të parashikuar nga pikat 1 e 2 të këtij neni, SIU informon njëkohësisht Departamentin e Policisë Kriminale.

4. SIU dërgon pranë strukturave homologe të përpunimit të të dhënave të udhëtimit të dhënat, të cilat nuk janë pseudonimizuar dhe/ose, kur është e nevojshme, edhe rezultatit/rezultatet e përpunimit të këtyre të dhënave, nëse është kryer, sa më shpejt të jetë e mundur, bazuar në kërkesa të arsyeshme të autoriteteve të zbatimit të ligjit të vendeve të tjera apo agjencive ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje bashkëpunimi, por gjithmonë në funksion të parandalimit, zbulimit, hetimit ose ndjekjes penale të veprave terroriste ose krimeve të rënda.

5. Në rastet kur të dhënat e kërkuara janë pseudonimizuar, SIU do të sigurojë dërgimin e të dhënave të plota vetëm kur vlerësohet e nevojshme, për qëllimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, dhe pas miratimit të drejtorit të Departamentit të Policisë Kriminale.

6. Për çdo rast, shkëmbimi ndërkombëtar i të dhënave për arsyet e parashikuara në këtë nen bëhet nëpërmjet njoftimit të nëpunësit të ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave të SIU-t, i cili do të vlerësojë shkëmbimin e të dhënave.

7. Në çdo rast, shkëmbimi ndërkombëtar i të dhënave të udhëtimit dhe/apo i rezultateve të përpunimit të të dhënave kryhet në përputhje me ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 16

Formatet dhe protokollet e transferimit të të dhënave të udhëtimit

1. Formatet dhe protokollet e transferimit të të dhënave të udhëtimit janë:

- a) formatet për transferimin e të dhënave të pasagjerit:
 - i. EDIFACT PNRGOV, siç përshkruhet në udhëzimin e implementimit të EDIFACT;
 - ii. XML PNRGOV, siç përshkruhet në udhëzimin e implementimit të XML;
 - iii. PAXLISTE EDIFACT;
 - iv. JSON/XML *Custom Schema*;
 - v. iAPI,
 - b) protokollet për transferimin e të dhënave të pasagjerit:
 - i. IBM MQ;
 - ii. IATA Type B;
 - iii. AS4 *Profile of ebMS 3.0 Version 1.0, OASIS Standard, published on 23 January 2013* dhe përditësimet më pas;
 - iv. SFTP (*Secure File Transfer Protocol*);
 - v. HTTPS (REST API/SOAP);
 - vi. AS2 (*Applicability Statement 2*);
 - vii. MQ/AMQP (*Message Queues*);
 - viii. VPN + FTP/HTTP,
 - c) protokollet për transferimin e të dhënave të kargos janë të paktën:
 - i. HTTPS (REST API / SOAP);
 - ii. SFTP (*Secure File Transfer Protocol*);
 - iii. AS2 (*Applicability Statement 2*);
 - iv. X.400/VAN;
 - v. MQ/*Message Queues* (p.sh. IBM MQ, AMQP),
 - ç) formati i përmbajtjes për të dhënat për manifestin përmban të paktën:
 - i. UN/EDIFACT CUSCAR;
 - ii. XML;
 - iii. CSV/TXT;
 - iv. ANSI X12 309;
 - v. IATA Cargo-IMP/Cargo-XML.
2. Protokollet dhe formatet e transmetimit të të dhënave do të përditësohen nga SIU në bazë të nevojës në përmbushje të objektivave të sigurisë kombëtare dhe të asaj publike.

KREU IV

ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 17

Periudha e ruajtjes së të dhënave të udhëtimit

1. Të dhënat e udhëtimit, të transmetuara nga transportuesit të SIU dhe rezultatet e përpunimit të të dhënave të tilla ruhen në bankën e të dhënave të SIU-t për një periudhë pesëvjeçare pas transmetimit të tyre.
2. Të dhënat e udhëtimit dhe rezultatet e përpunimit të të dhënave fshihen pas përfundimit të periudhës 5-vjeçare të transmetimit ose pas një vendimi të formës së prerë nga autoritetet gjyqësore, kur të dhënat janë mbajtur me qëllim të parandalimit, zbulimit, hetimit ose ndjekjes së veprave penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 8, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi.
3. SIU do të fshijë rezultatet e përpunimit të të dhënave të udhëtimit, sapo ato nuk janë më të nevojshme për të informuar autoritetet operative, agjencitë e zbatimit të ligjit të vendeve të tjera apo

agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje bashkëpunimi.

4. Rezultati i përpunimit të të dhënave të udhëtimit për rastet pozitive do të mbahet nga SIU, për aq kohë sa është e nevojshme për të informuar autoritetet kompetente apo agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje bashkëpunimi, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

5. Rezultati i përpunimit të automatizuar pas rishikimit individual me mjete joautomatike, kur është vërtetuar se është negativ, do të mbahet për aq kohë sa të dhënat do të shkatërrohen, në përputhje me këtë rregullore, në mënyrë që të shmanget ky rezultat përpunimi, i vërtetuar se është negativ.

6. Me kalimin e afatit të ruajtjes së të dhënave, fshirja e informacionit bëhet në mënyrë të automatizuar.

Neni 18

Pseudonimizimi i të dhënave të udhëtimit

1. Pas kalimit të një periudhe prej gjashtë muajsh pas transmetimit të të dhënave, të gjitha të dhënat e udhëtimit do të pseudonimizohen nëpërmjet bërjes së padukshme për një përdorues të elementeve të të dhënave, që mund të shërbejnë për të identifikuar drejtpërdrejt pasagjerin, të cilit i referohen, apo kargon, si më poshtë vijon:

- a) emrin/emrat, përfshirë emrat e pasagjerëve të tjerë në të dhënat e regjistrit të pasagjerit;
- b) numrin e udhëtarëve, që udhëtojnë së bashku;
- c) adresën dhe të dhënat e kontaktit;
- ç) të gjitha informacionet për format e pagesës, përfshirë adresën e faturimit, në masën që mund të shërbejë për të identifikuar direkt pasagjerin, të cilit i referohet e dhëna e pasagjerit ose ndonjë person tjetër;
- d) informacionin për udhëtarë të shpeshtë;
- dh) informacionet e përgjithshme, në masën që mund të shërbejnë për të identifikuar direkt pasagjerin, të cilit i referohen të dhënat e pasagjerit;
- e) statusin e udhëtimit të pasagjerit, përfshirë konfirmimin, statusin e *check-in-it*;
- ë) mosparaqitjen për *check-in*, biletë pa rezervim;
- f) çdo e dhënë API, që mund të jetë grumbulluar;
- g) çdo e dhënë kargo e grumbulluar.

2. Pas kalimit të periudhës prej gjashtë muajsh, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, dhe pseudonimizimit të të dhënave, zbulimi i të dhënave të plota të udhëtimit lejohet vetëm nëse ekzistojnë shkaqe të besueshme se zbulimi i plotë i tyre është i nevojshëm për autoritetet kompetente, të cilat përpunojnë të dhënat e udhëtimit, me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin e ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në nenin 8, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

3. Zbulimi i të dhënave të plota të udhëtimit, pas pseudonimizimit të tyre, bëhet vetëm pas verifikimit të kushteve për zbulimin e tyre nga nëpunësi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave në SIU.

4. Të dhënat e pseudonimizuara në mënyrë automatike fshihen në mënyrë automatike.

5. Të dhënat e papseudonimizuara në mënyrë automatike, pas përmbushjes së kritereve për fshirjen e tyre, fshihen në mënyrë manuale nga specialisti i caktuar nga drejtuesi i SIU-t.

Neni 19

Regjistrimi i veprimeve me të dhënat

1. SIU do të regjistrojë në bazën e të dhënave të udhëtimit të paktën veprimet e mëposhtme të përpunimit të të dhënave, që kanë të bëjnë me:

- a) mbledhjen;
- b) përpunimin;
- c) transmetimin;
- ç) shkëmbimin për përdorimin kombëtar e ndërkombëtar;
- d) ruajtjen;
- dh) fshirjen/shkatërrimin;
- e) pseudonimizimin;
- ë) mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave.

2. Regjistrimet e përpunimit, shkëmbimit dhe transmetimit të të dhënave duhet të bëjnë të mundur verifikimin e arsyes, datën dhe kohën e këtyre veprimeve dhe, sa është e mundur, identitetin e personit, që ka konsultuar ose transmetuar të dhënat personale, si dhe identitetin e marrësve të të dhënave.

3. Aktiviteti i plotë i përdoruesve lë gjurmë për çdo veprim të kryer.

4. Regjistrimet, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të përdoren vetëm nga nëpunësi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave të SIU-t dhe autoriteti kombëtar mbikëqyrës, për të verifikuar ligjshmërinë e përpunimit dhe për vetëmonitorim, duke siguruar integritetin dhe sigurinë e të dhënave personale, si dhe në rastet e auditimeve.

5. Regjistrimet e veprimeve mbi të dhënat do të fshihen në të njëjtën kohë me të dhënat personale të lidhura me to.

Neni 20

Dokumentacioni i detyrueshëm

1. SIU mban dokumentacion të plotë në lidhje me të gjitha sistemet e përpunimit dhe procedurat që kryhen.

2. Dokumentacioni duhet të përmbajë të paktën informacionin për emrin dhe detajet e kontaktit të SIU-t dhe të personelit, i cili është i autorizuar të përpunojë të dhënat e udhëtimit dhe nivelet e ndryshme të autorizimit të hyrjes në sistem për kërkesat e bëra nga:

- a) autoritetet kompetente e operative;
- b) autoritetet e zbatimit të ligjit të vendeve të tjera;
- c) agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit.

3. Regjistrimet e mbajtura në lidhje me konsultimin dhe zbulimin e të dhënave duhet të tregojnë, veçanërisht:

- a) qëllimin, datën dhe kohën e operacioneve të tilla;
- b) aq sa është e mundur, identitetin e anëtarit të stafit të SIU-t, i cili aksesoi të dhënat e udhëtimit, si dhe identitetin e marrësve të atyre të dhënave.

4. Regjistrimet e mbajtura, sipas pikës 3 të këtij neni, do të përdoren vetëm për qëllime të verifikimit, vetëmonitorimit, duke siguruar integritetin, sigurinë dhe auditimin e të dhënave, dhe ruhen për një periudhë 5-vjeçare.

Neni 21

Ruajtja e konfidencialitetit

1. Çdo punonjës, që përpunon të dhëna të pasagjerit apo vihet në dijeni të tyre, nuk mund t'u bëjë të njohur përmbajtjen e këtyre të dhënave personale të tjerë të paautorizuar. Ata detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit/detyrës.

2. Çdo punonjës i sektorit të inteligjencës së udhëtimit, me përfundimin e detyrës në këtë njësi, ka për detyrë të nënshkruajë deklaratën përkatëse, me anë të së cilës merr përsipër mosekspozimin e informacionit, me të cilin është njohur për shkaqe të ushtrimit të detyrës funksionale.

3. Ndaj çdo personi që hyn, komunikon ose i përdor të dhënat e udhëtimit në kundërshtim me këtë rregullore, merren masa të menjëhershme, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22

Të drejtat e subjektit të të dhënave

1. Përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë në përputhje me qëllimin, për të cilin janë përpunuar këto të dhëna.

2. Çdo person ka të drejtë të njihet me të dhënat personale të përpunuara nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Departamentit të Policisë Kriminale.

3. Për të gjitha rastet e përpunimit të të dhënave të pasagjerit, SIU është i detyruar të zbatojë këto të drejta të subjekteve të të dhënave:

- a) të drejtën për akses;
- b) të drejtën e informimit;
- c) të drejtën për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen;
- ç) të drejtën për t'u ankuar;
- d) të drejtën për kompensimin e dëmit;
- dh) të drejtën e barazisë e të mosdiskriminimit.

4. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar identitetin e kërkuarit. SIU, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

5. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kontaktojë nëpunësin e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave për çdo çështje që lidhet me grumbullimin, shpërndarjen apo përpunimin e informacionit të udhëtimit.

6. Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kontrolluesit kompensim, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Civil.

Neni 23

Autoriteti kombëtar mbikëqyrës

1. Autoritet kombëtar mbikëqyrës për të dhënat e pasagjerit është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkëpunon me SIU-n, në drejtim të këshillimit e monitorimit të zbatimit të dispozitave ligjore, lidhur me grumbullimin, përpunimin e shkëmbimin e të dhënave të udhëtarëve dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

- a) trajton, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ankesat e paraqitura nga çdo subjekt i të dhënave;
- b) verifikon ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, me iniciativën e tij ose në bazë të ankesave;

c) me kërkesë të çdo subjekti, jep rekomandime, me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me kërkesë të çdo subjekti të të dhënave, këshillon mbi ushtrimin e të drejtave, që gëzon sipas legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 24

Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave

1. Nëpunësi apo nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave caktohen nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe ata janë pjesë e strukturës organike të SIU-t.

2. Nëpunësi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave ka akses në të dhënat personale, që përpunohen dhe kryen këto detyra:

a) monitoron respektimin e kësaj rregulloreje dhe të politikave të kontrolluesit të të dhënave lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë aktivitetin e auditimit;

b) informon dhe këshillon stafin e SIU-t, i cili kryen përpunimin mbi detyrimet e tij në pajtim me këtë rregullore;

c) vepron si pikë kontakti për autoritetin kombëtar mbikëqyrës për çështjet në lidhje me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak;

ç) ofron këshilla për aktivitetet e ndërgjegjësimit, trajnimit e stafit dhe shpërndarjen e përgjegjësiave, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, si dhe këshillimin e monitorimin e kryerjes së vlerësimeve të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave;

d) vepron si një pikë kontakti për çështje që lidhen me përpunimin e të dhënave personale;

dh) duhet të marrë masat dhe të sigurojë që udhëtarët/subjektet janë të informuara qartë lidhur me mbledhjen e të dhënave dhe të drejtat e tyre.

3. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave merr pjesë në aktivitetet e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave.

4. Subjekti i të dhënave mund të kontaktojë nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave, si një pikë e vetme kontakti, për të gjitha çështjet në lidhje me përpunimin e të dhënave të këtij subjekti.

5. Në faqen zyrtare të SIU-t publikohen kontaktet e procedurat për komunikim me SIU-n dhe nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave.

6. Në rastet kur e vlerëson të nevojshme, nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave mund të referojë çështje për trajtim pranë autoritetit kombëtar mbikëqyrës për të dhënat e pasagjerit.

KREU V

RREGULLAT PËR MËNYRËN E NDËRVEPRIMIT TË SEKTORIT TË INTELIGJENCËS SË UDHËTIMIT ME AUTORITETET KOMPETENTE DHE AUTORITETET OPERATIVE

Neni 25

Pikat e kontaktit të autoriteteve kompetente

1. Titullarët e autoriteteve kompetente, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, caktojnë pikat e kontaktit në SIU dhe ia komunikojnë këtë SIU-t. Në rast ndryshimi të pikës së kontaktit nga titullarët e autoriteteve kompetente, njoftohet menjëherë SIU.

2. SIU ruan një regjistër të përhershëm të pikave të kontaktit, të aksesueshëm vetëm nga personeli i autorizuar i strukturës.

3. Pikat e kontaktit përfaqësojnë autoritetin për komunikimin me SIU-n.

Neni 26

Përfaqësuesit e autoriteteve operative

1. Titullarët e autoriteteve operative, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, caktojnë përfaqësuesit pranë SIU-t dhe ia komunikojnë këtë SIU-t. Në rast ndryshimi të përfaqësuesit nga titullarët e autoriteteve, njoftohet menjëherë SIU.

2. SIU ruan një regjistër të përhershëm të përfaqësuesve, të aksesueshëm vetëm nga personeli i autorizuar i strukturës.

3. Përfaqësuesit e autoritetit operativ caktohen për të bashkëpunuar me SIU-n dhe janë përgjegjës për:

a) kryerjen e detyrës sipas ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, dhe në përputhje me qëllimin ligjor;

b) përgatitjen dhe formalizimin e kërkesës për informacion, në përputhje me standardet e miratuara nga SIU;

c) dorëzimin e kërkesës nëpërmjet kanaleve të sigurta të komunikimit të miratuara nga SIU;

ç) koordinimin e brendshëm institucional për përdorimin e të dhënave të marra;

d) ruajtjen e konfidencialitetit, përdorimin e drejtë dhe dokumentimin e mëtejshëm të informacionit të shpërndarë nga SIU;

dh) mbajtjen e evidencave të përdorimit përfundimtar të informacionit, për qëllime transparence, gjurmueshmërie dhe auditimi.

4. Përfaqësuesit e autoriteteve operative veprojnë mbi bazën e parimit të nevojës për njohje dhe janë subjekt i kontrollit nga strukturat përgjegjëse.

Neni 27

Rregullat e ndërveprimit të pikave të kontaktit të autoriteteve kompetente me SIU-n

1. Komunikimi i pikave të kontaktit të autoriteteve kompetente me SIU-n kryhet nëpërmjet kanaleve të sigurta të miratuara nga SIU dhe dokumentohet, duke përfshirë të dhënat e identifikimit të pikës së kontaktit.

2. Furnizimi me informacion realizohet nga pikat e kontaktit, në formën e të dhënave të verifikuara dhe të justifikuara për arsye të ligjshme e të domosdoshme për ta përdorur.

3. Informacioni i dorëzuar nga pikat e kontaktit nuk mund të ripërdoret për qëllime të tjera pa miratimin e SIU-t dhe u nënshtrohet rregullave për ruajtje, fshirje dhe auditim.

4. Çdo ndërveprim i pikës së kontaktit me SIU-n regjistrohet në regjistrin e gjurmimit, i cili administrohet nga SIU dhe kontrollohet në mënyrë periodike për qëllime transparence e sigurie.

5. Të gjitha komunikimet kryhen vetëm nëpërmjet kanaleve sigurta të miratuara nga SIU, që garantojnë sigurinë teknike, integritetin e përmbajtjes dhe gjurmueshmërinë.

6. Çdo komunikim shoqërohet me kartelën përkatëse, sipas modelit të miratuar nga SIU, ku paraqiten të dhëna për qëllimin e saktë të informacionit të dërguar, identitetin dhe detyrën e pikës së kontaktit, që dërgon informacionin, datën, orën dhe institucion përkatës.

7. Në raste urgjente, pikat e kontaktit mund të përdorin një procedurë të shpejtuar të komunikimit, qoftë edhe verbal, por ky komunikim duhet të formalizohet menjëherë pas ngjarjes dhe SIU duhet të regjistrojë dhe të analizojë ligjshmërinë e përdorimit të procedurës urgjente.

Neni 28

Rregullat për mënyrën e ndërveprimit të përfaqësuesve të autoriteteve operative me SIU-n

1. Shkëmbimi i informacionit zhvillohet vetëm nëpërmjet kanaleve të sigurta të komunikimit dhe sistemeve të mbrojtura me identifikim elektronik institucional dhe autentifikim shumëfaktorësh.

2. Autoritetet operative kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin të dhëna PNR ose rezultatin e përpunimit të tyre nga SIU ose nëpërmjet SIU-t dhe nën mbikëqyrjen e tij, për analizimin dhe interpretimin e të dhënave të udhëtimit, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, për përmirësimin e kontrollit kufitar e doganor, parandalimin e migracionit të paligjshëm, si dhe parandalimin, zbulimin, hetimin e ndjekjen penale të krimeve, të parashikuara në pikën 1, të nenit 8, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

3. Çdo ndërveprim regjistrohet dhe i nënshtrohet një sistemi të gjurmimit, që përfshin datën, orën, identitetin e përdoruesit, përmbajtjen e kërkesës, statusin e trajtimit të kërkesës dhe përmbajtjen e përgjigjes.

4. Përdorimi i informacionit të marrë nga autoritetet kërkuese dokumentohet për çdo rast përdorimi fundor të tij, për qëllime të auditimit dhe garantimit të përdorimit të të dhënave vetëm për qëllimin, për të cilin janë kërkuar.

Neni 29

Trajnimi dhe autorizimi

1. Përfaqësuesit e autoriteteve operative trajnohen lidhur me mënyrën e ndërveprimit të tyre me SIU-n.

2. Vetëm personat e trajnuar autorizohen të kenë akses në sistemet e SIU-t.

Neni 30

Siguria, mbrojtja e të dhënave dhe mbikëqyrja

1. Ndërveprimet e SIU-t me autoritetet operative u nënshtrohen politikave të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka të drejtën e mbikëqyrjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VI

RREGULLAT PËR PROCEDURAT E AUTORIZIMIT TË TRANSMETIMIT TË INFORMACIONIT TË UDHËTIMIT

Neni 31

Kërkesa për autorizim

1. Transportuesi ose operatori ekonomik, që do të bëjë transmetimin e të dhënave të udhëtimit, do të paraqesë kërkesë me shkrim pranë sektorit të inteligjencës së udhëtimit për pajisjen me autorizim për transmetimin e të dhënave drejt SIU-t.

2. Së bashku me kërkesën për autorizim paraqitet/n edhe:

- a) emri tregtar dhe të dhënat e operatorit ekonomik ose transportuesit;
- b) një përshkrim teknik i sistemit të transmetimit;

- c) detaje për protokollet e sigurisë;
- ç) certifikatat teknologjike të sistemit;
- d) konfigurimet teknike për transmetimin e të dhënave (formatin e të dhënave, rrjetit dhe protokollit të transmetimit);
- dh) oraret e udhëtimeve dhe të dhënat e lidhura me testimin, konfigurimin dhe miratimin e sistemit të transmetimit të të dhënave të udhëtimit.

Neni 32

Testimi teknik dhe verifikimi

1. Transportuesi ose operatori ekonomik, që do të bëjë transmetimin e të dhënave të udhëtimit i nënshtrohet testimit teknik.
2. Strukturat e SIU-t bashkëveprojnë me autoritetin përkatës për transportin ajror, ujor apo tokësor, sipas rastit, për mundësimin e ushtrimit të testit teknik.
3. Për këtë qëllim, SIU i dërgon autoritetit përkatës për transportin ajror, ujor apo tokësor, sipas rastit, procedurat e kontaktit nëpërmjet të cilave transportuesit e identifikuar do të dërgojnë kërkesat për të filluar procedurën e autorizimit së bashku me oraret e përgjithshme të udhëtimit.
4. Testimi teknik përfshin testet e mëposhtme për transmetimin e informacionit të udhëtimit, sipas formateve të përcaktuara në nenin 16 të kësaj rregulloreje:
 - a) Testim i lidhjes (VPN, HTTPS, SFTP);
 - b) Testim i përputhshmërisë së të dhënave me sistemet e SIU-t;
 - c) Testim i rikuperimit në raste ndërprerjeje.
5. Në përfundim, mbahet raport teknik për rezultatet e testimit, i cili nënshkruhet nga drejtuesi i SIU-t dhe transportuesi/operatori ekonomik.

Neni 33

Vendimmarrja për autorizimin

1. Bazuar në raportin teknik të verifikimit e të propozimit të SIU-t, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit merr vendim për dhënie ose refuzim të autorizimit brenda 30 ditësh nga kryerja e testimit.
2. Me marrjen e vendimit për dhënie e autorizimit, transportuesi ose operatori ekonomik i kualifikuar nënshkruan kushtin për përgjegjësinë për transmetimin e të dhënave, për pjesën e kompetencës së tij specifike dhe garanton miratimin e masave të duhura teknike dhe organizative, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 34

Revokimi dhe pezullimi i autorizimit

1. Autorizimi për transmetimin e të dhënave të udhëtimit mund të pezullohet përkohësisht, në rastet kur:
 - a) konstatohen dështime teknike të përsëritura, që pengojnë transmetimin e rregullt të të dhënave;
 - b) të dhënat transmetohen në formate të papajtueshme me standardet e përcaktuara nga SIU;
 - c) transportuesi apo operatori ekonomik nuk bashkëpunon me strukturat përgjegjëse në kuadër të testimeve apo të kontrolleve/auditimeve;
 - ç) konstatohet mosrespektim i kushteve të autorizimit, që nuk përbëjnë rrezik të menjëhershëm për sigurinë ose të drejtat e subjekteve të të dhënave.
2. Autorizimi revokohet me propozim të SIU-t dhe vendim të DPPSH-së, kur:

a) konstatohen shkelje të qëllimshme të kushteve të sigurisë së transmetimit apo të përpunimit të dhënave;

b) dërgohen të dhëna të pasakta, të fabrikuara ose jashtë kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

c) nuk respektohen dispozitat e ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, në veçanti për masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale;

ç) ka ndryshime të njëanshme teknologjike apo organizative pa njoftim paraprak pranë strukturave përgjegjëse;

d) paraqitet rrezik i menjëhershëm për sigurinë kombëtare ose integritetin e sistemit të informacionit të SIU-t.

3. Vendimi për pezullim ose revokim i njoftohet menjëherë transportuesit ose operatorit ekonomik, me shkrim, duke përfshirë:

a) arsyetimin faktik dhe ligjor;

b) afatin dhe kushtet për rivendosjen e autorizimit (nëse zbatohet);

c) të drejtën për ankim, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Në rastet e rrezikut të drejtpërdrejtë për sigurinë publike ose për mbrojtjen e të dhënave personale, pezullimi ose revokimi hyn në fuqi menjëherë pas marrjes së vendimit pa kaluar në procedurë të ndërmjetme verifikimi.

5. Pezullimi mund të hiqet kur vërtetohet në mënyrë të dokumentuar se shkelja e rregullave, sipas pikës 1 të këtij neni, ka ardhur si pasojë e:

a) defekteve teknike të papritura në sistemet e transmetimit, të provuara dhe të dokumentuara;

b) forcës madhore (fatkeqësi natyrore, gjendje të jashtëzakonshme të konfirmuara me vendim të organit publik, sulme kibernetike), që e bëjnë objektivisht të pamundur transmetimin;

c) njoftimit paraprak ose të menjëhershëm të problemit dhe është bashkëpunuar me SIU-n për korrigjimin e tij;

ç) korrigjimit të shkeljes brenda afatit të arsyeshëm, kur nuk kanë ardhur pasoja.

KREU VII

RREGULLAT PËR FUNKSIONIMIN DHE PROCEDURAT STANDARDE TË PUNËS SË NJËSISË SË POSAÇME TË EMERGJENCAVE KOMBËTARE BRENDIA SIU-T

Neni 35

Mbledhja e njësisë së emergjencave kombëtare të SIU-t

1. Njësia e emergjencave kombëtare mblidhet me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme, mbi bazën e një njoftimi të verifikuar për emergjencë kombëtare, të paraqitur nga autoritetet kompetente ose operative.

2. Njësia e emergjencave të SIU-t përbëhet nga pika kontakti të autoriteteve kompetente, sipas nenit 9, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

3. Mbledhja e njësisë bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 24 orë nga marrja e urdhrat.

Neni 36

Zhvillimi i mbledhjes së njësisë

1. Pas thirrjes, drejtuesi i njësisë:
 - a) regjistron mbledhjen në protokollin elektronik të SIU-t;
 - b) thërret për pjesëmarrje pikat e kontaktit të autoriteteve kompetente.
2. Pikat e kontaktit paraqesin informacionin për situatën në kohë reale, në përputhje me kompetencat e tyre institucionale.

Neni 37

Komunikimi dhe ndërveprimi

1. Komunikimi ndërmjet anëtarëve të njësisë kryhet nëpërmjet kanaleve të sigurta elektronike të SIU-t.
2. Çdo informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror” qarkullon vetëm nëpërmjet kanaleve të sigurta të komunikimit, sipas standardeve dhe rregullave për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

Neni 38

Detyrat e njësisë

Detyrat e njësisë së posaçme të emergjencave kombëtare janë, si më poshtë vijon:

- a) Të koordinojë veprimet ndërmjet autoriteteve kompetente dhe operative gjatë emergjencave kombëtare;
- b) Të analizojë e të përpunojë informacionin e udhëtimit dhe të dhënat inteligjente të marra nga SIU për të identifikuar rreziqe në kohë reale;
- c) Të rekomandojë masa urgjente parandaluese dhe operative, të cilat i komunikohen menjëherë drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ministrit të Punëve të Brendshme;
- ç) Të sigurojë raportim periodik ditor për situatën deri në mbylljen e emergjencës.

Neni 39

Dokumentimi dhe raportimi

1. Çdo mbledhje e njësisë shoqërohet me procesverbal.
2. Procesverbali shpërndahet menjëherë tek të gjitha autoritetet përfaqësuese dhe ruhet në bazën e të dhënave të SIU-t.
3. Pas përfundimit të situatës së emergjencës, njësia përgatit një raport përfundimtar, që i dërgohet drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ministrit të Punëve të Brendshme.

Neni 40

Përgjegjësia

1. Pikat e kontaktit të autoriteteve kompetente dhe përfaqësuesit e autoriteteve operative janë përgjegjës për cilësinë dhe saktësinë e informacionit që paraqesin.
2. Moszbatimi i detyrimeve përbën shkelje të rëndë dhe raportohet nga drejtuesi i njësisë pranë autoriteteve përkatëse për masat disiplinore dhe administrative.

KREU VIII SANKSIONET

Neni 41

Konstatimi dhe zbatimi i sanksioneve

1. Në çdo rast kur SIU konstaton se të dhënat nuk janë dërguar apo kur të dhënat e dërguara janë të paplota apo të rreme, informon menjëherë autoritetin përgjegjës të vendit të destinacionit apo të nisjes.
2. Konsiderohen kundërvajtje administrative, nëse nuk përbëjnë veprë penale, veprimet apo mosveprimet e çdo transportuesi, që nuk transmeton apo transmeton të dhëna të paplota apo të rreme të pasagjerit.
3. SIU, nëpërmjet titullarit të Departamentit të Policisë Kriminale, vendos sanksionet e parashikuara në nenin 21, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.
4. Në rastet e shkeljeve të përsëritura apo të shkeljeve të rënda të detyrimeve, që rrjedhin nga neni 5, i ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, me kërkesën e SIU-it e propozim të Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ministri i Punëve të Brendshme mund të kërkojë pezullimin ose heqjen e së drejtës së kryerjes së veprimtarisë së transportuesit nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.
5. Në zbatimin e procedurave për vendosjen e sanksioneve zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.
6. Transportuesit kanë të drejtën e ankimit gjyqësor sipas ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.